



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 041
Prishtinë, më 7 dhjetor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 7 DHE 8 DHJETOR 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Enis KERVAN**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 64 deputetë.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në pajtim me nenin 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare të mbajtur me 6 dhjetor 2011, ka vendosur t'i propozojë Kuvendit që shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, të hiqet nga rendi i ditës.

Ai kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimin e lartëpërmendur të Kryesisë.

Kuvendi me shumicë votash vendosi që shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, të hiqet nga rendi i ditës.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,

4. Interpelancë me ministren e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari-Lila lidhur me masat e reciprocitetit me Serbinë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lojërat e fatit,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe të punëkërkesve,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e adresave,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të familjeve të tyre,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2010,
14. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim,
15. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike, për vitin 2010.
16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Teuta Haxhiu, Rexhep Selimi, Ramë Vataj, Haki Demolli, Visar Ymeri, Sala Berisha-Shala, Armend Zemaj, Fadil Demaku dhe ministri Ramë Buja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Sali Morina, parashtoi pyetje për ministren Mimoza Kusari-Lila, lidhur me numrin e zyrtarëve të larguar nga vendet e punës, që nga marrja e postit të ministres dhe cili është qëllimi i atyre largimeve.

Ministrja Kusari-Lila, iu përgjigj pyetjes së deputetit Sali Morina.

Deputetja Sala Berisha-Shala, parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të cilat dalin nga monitorimi i Ligjit për miniera dhe minerale, nga ana e ministrisë që ai e drejton.

Ministri Besim Beqaj, iu përgjigj pyetjes së deputetes Sala Berisha-Shala.

Deputeti Kurtan Kajtazi, parashtoi pyetje për ministrin Bedri Hamza, lidhur me veprimet që ka ndërmarrë ministria që ai drejton për zbatimin e obligimeve të dala nga Ligji për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës.

Ministri Bedri Hamza, iu përgjigj pyetjes së deputetit Kurtan Kajtazi.

Deputetja Salihe Mustafa, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani, lidhur me mos zbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga ana e ministrisë që ai drejton.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Salie Mustafa.

Pasi që pyetja e deputetes Nazane Breca për ministrin Ferid Agani ishte e njëjtë me atë të deputetes Salie Mustafa, kryetari konstatoi se edhe deputetja Nazane Breca mori përgjigje nga ministri Ferid Agani.

Deputetja Kimete Bytyqi, parashtoi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar, lidhur me atë se sa janë duke u zbatuar rekomandimet e ekspertëve të rishikimit funksional nga ana e Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive gjatë riorganizimit të tyre të brendshëm.

Ministri Mahir Yagcilar, iu përgjigj pyetjes së deputetes Kimete Bytyqi.

Deputetja Kimete Bytyqi, parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiq, lidhur me masat që ka ndërmarrë Inspektorati i Punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe numrin e kërkesave apo të kallëzimeve penale të ngritura ndaj kompanive që shkelin të drejtat e punëtorëve.

Ministri Nenad Rashiq, iu përgjigj pyetjes së deputetes Kimete Bytyqi.

Deputetja Nazane Breca, parashtoi pyetje për ministrin, Nenad Rashiq, lidhur me afatin kur pritet bartja e kompetencave të parapara në Ligjin për vetëqeverisjen lokale, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në instancat e pushtetit lokal.

Ministri Nenad Rashiq, iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputeti Goran Marinković, parashtoi pyetje për ministrin Besim Beqaj, lidhur me realizimin e të drejtave të konsumatorëve të cilët rregullisht i përmbushin obligimet ndaj KEK-ut, me theks të veçantë në komunën e Graçanicës.

Ministri Besim Beqaj, iu përgjigj pyetjes së deputetit Goran Marinković.

Deputeti Imri Ahmeti, parashtoi pyetje për ministrin Bedri Hamza, lidhur me autorizimin e investimeve të parasë publike në bankat e ndryshme komerciale brenda dhe jashtë vendit dhe nën cilat kushte është bërë kjo

Ministri Bedri Hamza, iu përgjigj pyetjes së deputetit Imri Ahmeti

Deputetja Rita Hajzeraj, parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja, lidhur me atë se pse në tekstet shkollore që ka blerë MASHT-i dhe që u janë shpërndarë nxënësve nëpër shkolla, nuk kanë çmim të ekspozuar në kopertinë.

Ministri Ramë Buja, iu përgjigj pyetjes së deputetes Rita Hajzeraj.

Deputetja Rita Hajzeraj, parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja, lidhur me ngritjen e komisionit të veçantë për përzgjedhjen e teksteve shkollore dhe autorizimin e dy shtëpive botuese “ Libri shkollor” dhe “Dukagjini”, që t’i shpërndajë ato.

Ministri Ramë Buja, iu përgjigj pyetjes së deputetes Rita Hajzeraj.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 11 dhe 17 nëntor 2011

Deputeti Armend Zemaj, pati vërejtje se emri i tij nuk ishte përfshirë në Procesverbalin e datës 17 nëntor 2011, që kishte diskutuar për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Deputetja Vjollca Krasniqi, pati vërejtje në Transkriptin e datës 11 nëntor 2011, ngase emri i saj ishte zëvendësuar me emrin e deputetes Hasime Krasniqi.

Procesverbali dhe Transkripti janë korigjuar, sipas vërejtjeve të deputetëve.

Me vërejtjet e cekura më lart, Kuvendi miratoi Procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 11 dhe 17 nëntor 2011.

4. Interpelancë me ministren e Tregtisë dhe Industrisë, znj. Mimoza Kusari-Lila, lidhur me masat e reciprocitetit me Serbinë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka parashtruar kërkesë për Interpelancë të ministres së Tregtisë dhe Industrisë, znj. Mimoza Kusari-Lila, lidhur me masat e reciprocitetit me Serbinë.

Ai, më tej i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e Interpelancës, prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar, në bazë të vendeve që kanë në Kuvend dhe për deputetët pa grup parlamentar, e cila është përcaktuar në bazë të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari ftoi propozuesin e Interpelancës ta marrë fjalën.

Deputeti **Visar Ymeri**, tha se prej vitit 1999 deri më sot Kosova nga Serbia ka importuar mallra në vlerë mbi dy (2) miliardë €, por në fakt kjo shifër është shumë më e lartë dhe arrin vlerën mbi katër (4) miliardë €. Ndërsa, në të njëjtën periudhë kohore, nga Kosova në Serbi janë eksportuar mallra në vlerë prej nëntëdhjetë e dy (92) milion €.

Në vazhdim të fjalës së tij, deputeti Visar Ymeri u fokusua në humbjet që shteti i Serbisë i ka shkaktuar Kosovës në të gjitha aspektet, si në numrin e të vrarëve, të të zhdukurve, të femrave të dhunuara gjatë luftë së fundit në Kosovë, numrin e shtëpive të rrënuara etj.

Pas pavarësisë së Kosovës, Serbia dy herë dogji pikat doganore të Republikës së Kosovës, konstatoi deputeti Ymeri.

Më tutje, ai tha se më 20 korrik 2011, Qeveria e Kosovës vendosi masat e reciprocitetit ndaj Serbisë dhe gjatë kësaj periudhe ishte shënuar rritje e shitjes së prodhimeve vendore prej 10- 50%. Masat e reciprocitetit dëshmuuan se produktet e Serbisë janë të zëvendësueshme në Kosovë, theksoi ai.

Arritjen e Marrëveshjes me Serbinë, e cila filloi të zbatohet me 16 shtator 2011, dhe heqjen e masave të reciprocitetit me Serbinë, ai i vlerësoi si çështje për të cilat Qeveria tregoi pavendosmërinë e saj.

Deputeti Visar Ymeri, më tutje paraqiti të dhëna për bilancin tregtar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë pas datës 16 shtator 2011.

Në fund, ai konstatoi se për të gjitha këto çështje, Qeveria duhet të japë llogari para qytetarëve të vendit dhe njëkohësisht çështjen e reciprocitetit e kemi shtruar sot në Kuvend, për debat.

Ministrja **Mimoza Kusari-Lila**, fillimisht tha se e mirëpret kërkesën për këtë interpelancë.

Në vazhdim, ministrja Kusari-Lila, vendimin për masat e reciprocitetit me Serbinë e vlerësoi si vendimin më të rëndësishëm pas shpalljes së pavarësisë së vendit.

Më tej, ajo u fokusua në shifrat konkrete të importeve dhe të eksporteve Kosovë-Serbi nga viti 2008 e deri më tani.

Ajo theksoi se pas fillimit të zbatimit të masave të reciprocitetit me Serbinë nga 20 korriku 2011, disa njerëz as që kanë besuar se një gjë e tillë është duke ndodhur. Fillimi i dialogut teknik me Serbinë ka rezultuar me arritjen e marrëveshjeve Kosovë-Serbi, nën mbikëqyrjen e BE-së dhe të SHBA-ve, me ç'rast Serbia njohu vulat doganore të Kosovës, duke lejuar importin dhe transitin e produkteve të Kosovës në/për Serbi.

Nëse ne sot importojmë më shumë mallra nga Serbia se sa eksportojmë atje, kjo nuk ka të bëjë me çështje të reciprocitetit, por ka të bëjë me kapacitetet prodhuese të vendit, konstatoi ministrja Kusari-Lila.

Më tej, ajo paraqiti qëndrimin e Qeverisë rreth parimeve për tregti të lirë dhe se qëllimi ynë nuk është të izolohehi, ndërsa transiti i mallrave të Kosovës nëpër Serbi - për në Evropë, është i një rëndësie tjetër për Kosovën.

Lidhur me importet nga Serbia, ajo tha se ato arrijnë vlerën e 270 milion €, në vit, duke kundërshtuar shifrat e paraqitura për këtë çështje nga parashtruesi i interpelancës. Ajo gjithashtu konstatoi se për plasimin e prodhimeve të Kosovës në Serbi, eksportuesit tanë nuk janë të detyruar të marrin dokumente në strukturat paralele serbe.

Ajo, në fund bëri një rezymë të të arriturave të Kosovës në drejtim të përmirësimit të bilancit tregtar të Kosovës me Serbinë por edhe me vendet e tjera të rajonit, sidomos, me theks të veçantë pas 20 korrikut 2011, duke konstatuar se proceset e integritit evropian nënkuptojnë edhe liberalizimin e tregtisë rajonale dhe më gjerë.

Kryetari hapi diskutimin lidhur me Interpelancën e ministres së Tregtisë dhe Industrisë, znj. Mimoza Kusari-Lila.

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se mbështesim qëndrimet dhe veprimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me masat e reciprocitetit të zbatuara në raport me Serbinë dhe arritjen e marrëveshjeve nën mbikëqyrjen e BE-së dhe SHBA-ve.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se e kemi mirëpritur vendosjen e masave të reciprocitetit më 20 korrik 2011, në raport me Serbinë, të cilat kanë dhënë efektet e veta. Ai, më tej, për Marrëveshjet e arritura me Serbinë tha se nuk po respektohen sa duhet nga ana e shtetit fqinj, ndërsa veprimin e Qeverisë për heqjen e masave të reciprocitetit me Serbinë, Grupi Parlamentar i LDK-së e vlerëson si të ngutshëm.

Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, fillimisht tha se dy datat shumë të rëndësishme për Kosovën, 20 korriku 2011 dhe 25 korriku 2011, u shuan, e para më 16 shtator 2011, ndërsa e dyta më 26 korrik 2011.

Serbia nuk duhet të kushtëzohet vetëm ekonomikisht, por edhe politikisht. Asaj duhet t'i pamundësohen disa synime në mënyrë që të jemi partner vërtet reciprok dhe të barabartë, konstatoi deputeti Konjufca.

Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se Kosova ka përfituar nga masat e reciprocitetit, por fatkeqësisht vetëm disa ditë. Qeveria duhet të qartësojë për opinionin shumë elemente të masave të reciprocitetit.

Në vazhdim, tha se grupi parlamentar që ai përfaqëson, përkrah iniciativën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për këtë interpelancë dhe do të angazhohen në riformulimin e rekomandimeve të paraqitura nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

Më pas, ai u fokusua në Marrëveshjen për menaxhimin e integruar të kufirit me Serbinë, për të cilën përfaqësues të Qeverisë së Kosovës deklaruan se Serbia na njohu de jure, ndërkohë që këto konstatime të zyrtarëve qeveritar ai i konsideroi si mashtrime.

Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se kemi mbështetur masat e reciprocitetit me Serbinë dhe kërkoi një zbatim më rigoroz të marrëveshjeve të arritura me palën serbe në kuadër të dialogut teknik.

Sa iu përket rekomandimeve të propozuara për këtë interpelancë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, ai tha se nuk e përkrahim rekomandimin nr. 1, rekomandimi nr. 2 nuk është funksional, ndërsa rekomandimi nr. 3 duhet të riformulohet.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë çështje dhanë edhe këta deputetë: Berat Buzhala, Donika Kadaj-Bujupi, Florin Krasniqi, Bekim Haxhiu, Ganimete Musliu, Visar Ymeri, Ismet Beqiri, Emin Gërbeshi dhe ministrija Mimoza Kusari-Lila

Diskutimet e plota të përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të deputetëve janë dhënë në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund, në emër të propozuesit të Interpelancës, deputeti Visar Ymeri paraqiti tekstin e Mocionit, të përbërë prej tri pikave, dhe i ftoi deputetët për miratim të tekstit të mocionit.

Kryesuesi **Enis Kervan**, hodhi në votim tekstin e Mocionit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, lidhur me masat e reciprocitetit me Serbinë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 42,
Kundër----- 33,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e rekomandimeve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

1. Qeveria t'i marrë masat e reciprocitetit të plotë politik, ekonomik dhe tregtar ndaj Serbisë.
2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ta nxisë dhe udhëheq bashkëpunimin me prodhuesit vendorë dhe ndërmarrjet tregtare për gjetjen zëvendësimeve për produktet e importuara nga Serbia.
3. Qeveria t'i forcojë të gjithë mekanizmat shtetëror për ta siguruar zbatimin e përpiktë të masave të reciprocitetit ndaj Serbisë.

Kryetari, pas pauzës, para se të vazhdohej me pikën e radhës të rendit të ditës, i njoftoi deputetët se tre (3) deputetë kanë tërhequr votimet e tyre lidhur me pikën nr 4 të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.

Ministri **Hajredin Kuçi**, tha se nevoja për nxjerrjen e këtij Projektligji është shumë e madhe, pasi që deri më tani është në fuqi ligji përkatës, ai i ish-RSFJ-së, i vitit 1978.

Në vazhdim, tha se ky projektligj përmban parimet themelore dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhëniet e detyrimeve. Ligji pas miratimit do të shërbejë si bazë kryesore juridike për qarkullimin e mallrave, të shërbimeve dhe të hollave në ekonominë e tregut.

Ai, më tej u fokusua në strukturën e këtij projektligji, i cili është mjaft voluminoz dhe si i tillë është i ndarë në dy pjesë: pjesa e përgjithshme ose libri i parë dhe pjesa e veçantë ose libri i dytë.

Më tej, ministri i Drejtësisë theksoi se ky projektligj, bashkë me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, Ligjin për trashëgiminë, Ligjin për familjen përbën bazën e Kodit Civil të ardhshëm, të cilin do ta sjellim në Kuvend.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Legjislacion, deputeti Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Amir Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, si dhe ministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	71,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	1.

Kryetari, konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lojërat e fatit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për lojërat e fatit.

Ministri **Bedri Hamza**, tha se Projektligji për lojërat e fatit përcakton në mënyrë të qartë aktorët për politikën dhe menaxhimin e lojërave të fatit, standardet të cilat duhet t'i përmbushin subjektet e lojërave të fatit dhe subjektet që kryejnë këtë veprimtari.

Kjo fushë deri më tani ka pasur disa zbrastësira juridike të cilat konsistojnë në procedurat e licencimit, tatimit dhe mbledhjes së ndëshkimeve, theksoi ministri.

Ai më tej u fokusua në strukturën e këtij projektligji, për të cilin tha se përbëhet prej 10 kapitujve dhe foli në vija të përgjithshme për ata kapituj.

Në procedurën e përpilimit të këtij projektligji, përpos ekspertëve vendorë, një ndihmë shumë të çmueshme kanë dhënë edhe ekspertë të Thesarit amerikan, për të cilët ministri Hamza tha se jemi shumë mirënjohës.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për lojërat e fatit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadergjonaj, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavljeviq, si dhe deputetët: Valbona Dibra, Shaip Muja, Armend Zemaj, Jeton Svirca, Gëzim Kelmendi dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,
Kundër----- 5,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për lojërat e fatit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ministri **Agim Çeku**, tha se Projektligji për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, rrjedh si obligim nga ligji nr. 03/L-82 për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe i ndihmuar nga këshilltarët e ekipit këshillues të NATO-s, që veprojnë në kuadër të MFSK-së.

Ai më tej tha se ky projektligj adreson çështjet që kanë të bëjnë me pagesat financiare për pjesëtarët e FSK-së, pas ndërprerjes së shërbimit të tyre në FSK, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në raste të pensionimit, të drejtat e trashëgimtarëve të tyre në rast të vdekjes së pjesëtarit të FSK-së, etj.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti, Anton Quni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Emin Gërbeshi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, si dhe deputetët: Lumnije Morina, Armend Zemaj dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve.

Ministri **Nenad Rashiq**, tha se Projektligji për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve rregullon: mënyrat, procedurat, kushtet e regjistrimit, evidentimit dhe çregjistrimit të të papunësuarve dhe punëkërkuesve, të cilët kërkojnë punë në zyrat e punësimit në territorin e Republikës së Kosovës.

Ai më tej tha se si rezultat i mungesës së normave juridike për rregullimin e regjistrimit dhe krijimin e evidencës ka pasur ngecje në drejtim të organizimit sa më të mirë të

punëve lidhur me krijimin e një evidence të mirëfilltë si dhe për realizimin e të drejtave të tyre nga lëmi i punës dhe i punësimit.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Salihe Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nazane Breca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, si dhe deputeti Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	70,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Ministri **Nenad Rashiq**, tha se nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare konsiston në avancimin dhe rregullimin në mënyrë më të hollësishme të kompetencave, rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve që do të merren me këtë çështje.

Ai më tej theksoi se qëllimi i projektligjit është sqarimi dhe eliminimi i keqkuptimeve ligjore që dalin si rezultat i zbatueshmërisë së ligjeve tjera në fushën e shërbimeve sociale e familjare.

Ministri Rashiq më pas foli edhe për strukturën e projektligjit dhe elaboroi aspekte të tjera që lidhen me fushëveprimin e këtij projektligji.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Salihe Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Bahri Thaçi, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pas kësaj pike të rendit të ditës, kryetari propozoi që punimet e Kuvendit për ditën e sotme të përfundojnë dhe propozoi që mbledhja plenare të vazhdojë me dt. 8 dhjetor 2011, për pikat e mbetura.

Kryetari kërkoi nga Kuvendi që me një votim formal të përkrahin propozimin e lartpërmendur.
Kuvendi miratoi propozimin e kryetarit.

Kryetari konstatoi të mbyllur punimet nga mbledhja e sotme, ndërsa vazhdimi i saj, tha se do të bëhet më 8 dhjetor 2011.

E hënë, më 8 dhjetor 2011

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Enis KERVAN**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë dhe procedoi me pikat e rendit të ditës.

Në fillim për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Haki Demolli deklaroi se kishte votuar “**për**” mocionin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, ndërsa nuk ishte evidencuar se ai ka votuar.

Duda Balje, propozoi që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e adresave të shtyhet për një mbledhje tjetër, me arsyetimin se duhet të përfshihen edhe gjuhët e komuniteteve tjera në këtë projektligj.

Fatmir Xhelili, në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, tha se nuk ka asnjë arsye që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet, ngase përdorimi i gjuhëve është rregulluar me ligj të veçantë.

Arsim Bajrami, theksoi se nuk ka arsye që ky Projektligj të shtyhet për më vonë, sepse përdorimi i gjuhëve është rregulluar me Ligjin për gjuhët.

Ahmet Isufi, tha se çështja e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës është rregulluar me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, ndërsa komunat janë të obliguara të zbatojnë ligjin.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim propozimin e deputetes Duda Balje.

Kuvendi, me shumicë votash, nuk miratoi propozimin e deputetes Duda Balje, për shtyrjen e shqyrtimit të dytë të Projektligjit për sistemin e adresave.

Kuvendi i vazhdoi punimet me pikat e mbetura nga mbledhja e filluar më parë.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e adresave

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për sistemin e adresave.

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Fatmir Xhelili.

Pasi që nuk pati deputetë të tjerë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Pastaj, kryetar hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	62,
Kundër-----	6,
Abstenime-----	2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për sistemin e adresave.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Raportin e Komisionit funksional për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti Goran Marinković.
Pasi që nuk pati deputetë të tjerë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentin nr.1 dhe amendamentin nr. 2.

Pastaj, kryetari hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	57,
Kundër-----	11,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të familjeve të tyre

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të familjeve të tyre.

Raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e arsyetoi zëvendëskryetarija e parë e këtij komisioni, deputetja Time Kadrijaj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë deputetët: Aurora Bakalli, Liburn Aliu, Rexhep Selimi, Sali Asllanaj, Emin Gërbeshi dhe Ahmet Isufi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentet: 2A, 3, 4, 5 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24 dhe 25.

Kuvendi nuk miratoi amendamentet nr. 1 dhe nr.18.

Kryetari, më tej hodhi në votim edhe dy amendamentet nga raporti plotësues i Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të propozuara nga Komisioni për Legjislacion.

Kuvendi miratoi amendamentet plotësuese nr. 1 dhe nr.2

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të familjeve të tyre.

13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2010

Deputeti **Ali Sadriu**, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, tha se komisioni që ai drejton ka shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2010, dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ai, më tej tha se është vlerësim i komisionit që ai drejton, se gjendja në këtë Ministri është mjaft shqetësuese dhe se raporti kthyes i kësaj Ministrie për Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike është shumë i përgjithësuar.

Të gjeturat që përmban Raporti janë serioze dhe mbi këtë bazë Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka vlerësuar se nevojitet që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë auditim të performancës në këtë ministri, vlerësoi deputeti Sadriu.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes” Vetëvendosje”, Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bali Muharremaj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, deputetja Valbona Dibra si dhe ministri Tomiç Radojica, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** hodhi në votim miratimin e rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 51,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Miratohen rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2010.

14. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ripranim

Deputeti **Fatmir Xhelili**, në emër të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, tha se si komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim dhe Kuvendit i kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni funksional.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Anton Quni, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Emin Gërbeshi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** hodhi në votim miratimin e raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 73,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti me rekomandime i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 03/L-203 për ripranim.

15. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike, për vitin 2010

Deputeti **Zenun Pajaziti**, tha se në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2010, Kuvendi i kemi paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti që ka paraqitur Komisioni funksional.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe: Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa, Danush Ademi dhe ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** hodhi në votim miratimin e raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 43,
Kundër----- 14,
Abstenime----- 17.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike, për vitin 2010.

16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit në Bordin e Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kryetari i njoftoi deputetët për raportin e Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, lidhur me emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e emërimit të anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Kryetari, në vazhdim tha se pasi që janë propozuar dy kandidatë për një pozitë, atëherë duhet të bëhet votimi i fshehtë.

Kuvendi votoi për formën e votimit të fshehtë për emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Më pas, kryetari tha se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të administratës dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK, Ramiz Lladrovci,
2. GP LDK, Sali Morina,
3. GP Vetëvendosje – Albulena Haxhiu,
4. GP AAK, Bali Muharremaj,
5. GP Koalicioni Kosova e Re – Amir Ahmeti,
6. GP SLS, Bojan Todoroviq,
7. GP “6+” - Rasim Demiri.

Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionin votues.

Në vazhdim, kryesuesi ftoi deputetët një nga një, për të votuar.

Pas votimit dhe numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Ramiz Lladrovci. Ai tha se në votim kanë marrë pjesë 85 deputetë.

Për Naim Hysenin, kanë votuar 5 deputetë,
Për Ramiz Krasniqin, kanë votuar 72 deputetë.
Të pavlefshme, 8 fletëvotime.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Ramiz KRASNIQI, emërohet anëtar i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
2. Mandati i të emëruarit nga pika nr. 1. e këtij vendimi është katër (4) vjet.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 15 : 18 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.